

Kantonsärztlicher Dienst

Albanische Übersetzung des Formulars "Merkblatt für die Eltern über Kopfläuse" / Ausgabe Oktober 2004

Fletudhëzimi për prindërit rreth morrave të kokës

Ku gjenden morrat e kokës?

Morrat e kokës janë të përhapur në gjithë botën. Ata vërtetë janë të pakëndshëm, por janë gjithashtu edhe të parrezikshëm. Bartja e tyre bëhet zakonisht drejtëpërdrejtë nga koka në kokë, p.sh: gjatë lojës, në sport, në shkollë ose në shtëpi, rrallëherë nëpërmjet sendeve të vdekura si: (në brusha, krehër, kapele, shallë, rroba krevati, poashtu në peshkirët e duarve dhe të banjës). **Shfaqja e morrave të kokës është në kundërshtim me mendimin e përhapur se janë rezultat i mungesës së higjienës.** Edhe larja e përditshme e flokëve nuk e mbron kokën nga ngjitja e morrave. Ngjitja e morrave nuk do të duhej në çfarëdo rrethane të fshihej.. Vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi është e mundur të arrijmë me efikasitet t'i luftojmë morrat e kokës.

Si i dalloni (njihni) morrat e kokës?

Morrat e kokës është vështirë të dallohen vetë. Ata janë insekte rreth 3 mm të vegjël (sa fara e një bime). Ata ngjiten fort në kokë dhe lëkurë të njeriut: ata kërcejnë por nuk fluturojnë. Morrat iu përshaten ngjyrës së flokëve. Ata shkaktojnë një kruarje të përherëshme në lëkurë të kokës dhe i detyrojnë njerëzit të kruhen rregullisht në flokë. Në rrënjë të flokëve lëshojnë vezë (të ashtuquajtura thërijë). Këto thërija (me ngjyrë të hapur, rreth 1 mm të mëdha në formë qeseje) është lehtë të dallohen. Ato duken si krunde flokësh, por ngjiten fort në flokë. Ato janë e kundërta e heqjes së krundeve; vështirë të hiqen dhe zhduken me një shampun të zakonshëm. Në raste të shpeshta njeriu i gjen thërijat në tëmth, nën veshë dhe në zverk. **Vetëm një thërijë e vetme dëshmon për infektim (koka duhet të mjekohet menjëherë).** Pas 7 deri në 10 ditë morrat e rinj bien.

Çfarë duhet të bëni?

1. Lajmëroni menjëherë edukatoren/edukatorin, personelin arsimor, nëse te fëmija juaj keni vërejtur morra ose thërija.
2. Fëmijët në kopsht ose në shkollë do të kontrollohen nga mjeku i shkollës ose nga një person i ngarkuar për sëmundje të morrave.
3. Nëse te fëmija juaj nuk janë gjetur thërija ose morra, prap se prap duhet që dy herë në javë të kontrolloni flokët e fëmijës tuaj, deri në atë moment që të jetë konstatuar se te bashkëshkollarët e fëmijës tuaj nuk janë gjetur më morra.
4. **Nëse fëmija juaj është infektuar me morra, ju jeni përgjegjës për marrjen e masave të mjekimit.** Mjekja/mjeku i shkollës ose mjekja/mjeku i shtëpisë qëndrojnë në dispozicionin tuaj për këshillim.

Emri i fëmijës: _____

Shumë të nderuar prindër

Gjatë kontrollimit më _____ është konstatuar se në klasën e fëmijës tuaj janë gjetur morra.















- Te fëmija juaj janë gjetur **morra ose thërija**. Ju lutemi, që sipas këtij fletudhëzimi, mjekimin ta merrni përsipër që sot.
- Te fëmija juaj **nuk janë gjetur thërija**. Megjithatë, ju lutemi që në ditët dhe javët e ardhshme flokët e fëmijës tuaj t'i kontrolloni rregullisht, të paktën dy herë në javë në kërkim të thërijave. Nëse shfaqen thërija apo morra, duhet të filloni menjëherë mjekimin sipas udhëzimit të këtij fletudhëzimi.

Me përshëndetje shoqërore

Mjeku/mjekja e shkollës

Udhëzime praktike për masat e mjekimit

- Flokët e fëmijës që i janë ngjitur morrat, mund të mjekohen menjëherë me barëra si p.sh: me Prioderm, Loxazol (shiko poshtë)! **Ndryshime në produktet e ofruara janë në çdo kohë të mundshme! Orientimet në shtojcën e paketimit të barërave i ndiqni drejt.** Farmacistja/farmacisti juaj, ose mjekja/mjeku i shtëpisë qëndrojnë në dispozicionin tuaj për këshillim.
- Edhe anëtarët tjerë të familjes duhet të mjekohen njëkohësisht edhe nëse nuk u janë ngjitur morrat. Gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji ose foshnjat duhet që para fillimit të mjekimit të kontaktojnë me mjekun/mjekën e shtëpisë. Kafshët shtëpiake nuk duhet të mjekohen.
- Veç kësaj, rrobat e përdorura të trupit, rrobat e krevatit si dhe peshkirat e duarve dhe të banjës duhet që njëkohësisht të pastrohen të paktën në 60 gradë. Pastrimi kimik është poashtu i suksesshëm.
- Rrobat që nuk zihen, ose nuk lahen (p.sh, kafshët nga pelushi) vehen të ruhen në një çese plastike të mbyllur për 14 ditë ose mund të qëndrojnë të paktën 24 orë në ngrirje të thellë.
- Krehërit, brushat dhe artikujt tjerë personal të tualetit që lahen, mund të lahen gjatë 10 minutave (54°C) në ujë të nxehtë me sapun.
- Mobilet, mbulesat, dyshekët, jastekët, helmetat e biçikletave, divanet, ulëset e makinës mund të fshihen me fshesë elektrike.
- Kapelat, shallët, helmetat e biçikletave, krehërit, brushat, kapëset e flokëve nuk duhet të ndërrohen me njëri-tjetrin. Flokët e gjata duhet të lidhen.
- Pas përfundimit të mjekimit, gjenden ende thërija, të cilat ngjiten në flokë. **Të gjitha thërijat duhet të hiqen me ndihmë të krehërve specialë për thërija, me thonjë ose me gërshërë. Kështu mjekimi është kryer komplet.**

Dita 1.	 <p>Rrobat e krevatit Rrobat</p>	 <p>e ujë të sapunosur 60°C</p> <p>Kafshët kukulla</p> <p>14 ditë!</p>
PRIODERM		LOXAZOL
 <p>Flokët lahen me Prioderm</p>	 <p>Flokët lahen me shampon normal!</p>	
<p>Pas 5 minutash</p> 		
 <p>Flokët lahen me Prioderm</p>	 <p>(shishen të plotë!)</p> <p>Flokët lahen me Loxazol</p>	
<p>Pas 5 minutash</p> 	<p>Pas 10 minutash</p> 	
 <p>Të krihen flokët</p>	 <p>Të krihen flokët</p>	
		
Dita 2.		
Dita 3.		
Dita 4.		
Dita 5.		
Dita 6.		
Dita 7.		
Dita 8.		
Dita 9.		



T'i iket kontaktit nga uji me klor



Flokët nuk duhet të lahen me shampon të zakonshëm



Flokët pas larjes nuk duhet të thahen